

GIJRKATA E QARKUT NË PRIZREN trupi gjykues i shkallës së dytë prej tre gjyqtarëve me anëtarë gjyqtari Vladimir Kanev, gjyqtari ndërkombëtar civil i EULEX-it si kryetar i trupit gjykues, gjyqtari Klaus Huener, gjyqtari ndërkombëtar civil i EULEX-it dhe gjyqtari Erdogan Haxhibeqiri, gjyqtari civil i GJQ të Prizrenit si anëtar te panelit, pas konsiderimit të ankesës, të parashtruar nga [REDAKTUAR] të përfaqësuar nga [REDAKTUAR] prej Prishtinës kundër Aktvendimit të datës 22.10.2009 për hedhjen poshtë të çështjes së gjykatës komunale të Prizrenit C N 422/09, me të paditurin [REDAKTUAR] prej Prizrenit, ne seancën e kolegjit te mbajtur me 19.02.2010 morri këtë:

AKTVENDIM

PRISHEJ aktvendimi i gjykatës komunale Prizren C.nr. 422/09 të datës 22.10.2009 dhe çështja i RIKTHEHET gjykatës komunale të Prizrenit për vendosje te sërishme.

ARSYETIM:


Rasti i shkallës së parë në çështje kishte filluar në gjykatën komunale të Prizrenit më 19.05.2005. Paditësi [REDAKTUAR] pretendon se që nga viti 1993 ajo është pronarja e pasurisë së palëvizshme në Kosovë, domethënë një parcelë ndërtimi [REDAKTUAR] parcelë-kadastrale [REDAKTUAR] në Prizren. Në vitin 1997 me lejen e vlefshme të ndërtimit ajo filloi ndërtimin e shtëpisë dhe sipas saj e kreu katin e përthes dhe katin e parë.

Në muajin gusht 1999 familjes së saj i duhej të lëshoj Prizrenin për shkak të trajtimit dhe sulmeve ndaj saj dhe bashkëshortit të saj.

Sipas padisë në vitin 2002 i pandehuri [REDAKTUAR] në mënyrë të paligjshme e uzurpoji pronën në fjalë dhe vazhdoi punët e ndërtimit të cilat ishin ndërmarr nga paditësi. Këshilla juridike e kërkuar është nën nenin 25 të Ligjit mbi marrëdhëniet pronësore. Djordjevic pretendon se parcela e saj është rregulluar në rrethanat e mëparshme nga ana e të paditurit dhe nën shpenzimet e tij.

Më 22.10.2009 Gjykata komunale në Prizren i hodhi poshtë procedurat si të paprannueshme. Shkalla e parë në aktvendimin e saj tha se:

“Në rastin konkret, sipas nenit 2.5 të Rregullores 1999/23, për Fondacionin e drejtorisë dhe komisionit për shqyrtimin e kërkesave lidhur me çështjet e banimit, lidhur me nenin 1.2 (c) të Rregullores së përmendur, në rastet kur “ ankesat e parashtruara nga personat natyrale të cilët ishin pronar ose posedues të pronës ose kanë pasur të drejtën e banimit para 24.03.1999, momentalisht nuk i kanë në posedim, dhe kur e drejta e pronës nuk është dorëzuar vullnetarisht”, janë përfashtuar nga kompetenca e gjykatës vendore.



Komisioni i përmendur ka kompetencën përbarimore për ato raste i takojnë kategorisë 1.2 të rregullores së përmendur më lartë.

Kompetenca e organit të përmendur dhe kërkesat që janë nën kompetencat e tyre përbarimore parashihen gjithashtu me nenin 2.2 dhe nenin 3.1 lidhur me nenin 8.3 të Rregullores nr. 2000/60, përfshirë ndërrimet e fundit në to.

Në shqyrtimin kryesor të mbajtur më 22.10.2010 Gjykata e shikoi dokumentin e habitatit të datës 30.04.2005, me çka prona e paditësit i është rikthyer asaj dhe i padituri ishte i obliguar që në afat prej 30 ditësh të lëshoj pronën e përmendur. Vendimi i njëjtë ishte i vërtetuar nga ana a organit të njëjtë më 16.12.2005, më pas në rastin konkret çështja mes palëve ishte zgjidhur me vendimin e lëshuar nga ana e komisionit për çështje pronësore dhe të banimit, prandaj Gjykata është e obliguar që sipas nenit 2.7 të Rregullores së përmendur më lartë të përfill vendimin e lëshuar nga ana e komisionit; vendime të tilla nuk mund të bëhen objekt i rrygkimit.


Dispozitat e përmendura më lartë e përjashtojnë kompetencat e kësaj gjykate me qëllim që të vendos në këtë çështje ligjore; ndonëse kjo gjykatë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, lidhur me nenin 17 (1) të LPK.”

Thjesht GJK në Prizren e anuloi rastin për shkak të çështjes tashmë të gjykuar mbi këtë rast, me sa duket të lëshuar nga vendimi i përmendur më lartë të KKBP.

Ankesa, e parashtruar brenda afatit kohor në emër të [REDAKTUAR] hit cek se shkalla e parë e keqkuptojt padinë dhe me gabim e zbatoi ligjin procedural. Sipas ankesës çështja në fjalë është e drejta pronësore, e jo posedimi. I pandehuri u përgjigj ankesës dhe e theksoj qëndrimin e tij se paditësi nuk është pronar i parcelës në këtë çështje.

Ankesa pranohet si e themeltë. Ajo është parashtruar brenda afatit kohor ligjor dhe i ka të gjitha kushtet e detyrueshme. E konsideruar në thelb kjo ankesë është e bazuar mirë.

Aktivendimi i ankinnuar paraqet një ngatërrim të madh midis dy llojeve të ndryshme të njeteve ligjore. Mjeti ligjor nën nenin 1.2 (c) Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 i jepet paditësve të cilët e kanë humbur të drejtën e tyre të posedimit mbi pasurinë e paluajtshme nën rrethanat e parashtruara në atë Rregullore. Veprimi ligjor nën nenin 25 LMP është plotësisht i ndryshëm. Ai jepet pronarëve me të drejta themelore parcelat e të cilëve janë marr ilegalisht nga personat e paautorizuar. Varet nga paditësi se cilat nga këto tri mundësi nën nenin 25 do ti zgjedh. Në këtë rast paditësi e zgjodhi mundësin “rindërtimi i kushteve të mëparshme”, por vetë padia është e paqartë dhe e papërcaktuar, sepse Gjykata komunale në Prizren nuk e ka
ndjekur detyrën e vet nën nenin 102 Ligji mbi Procedurën Kontestuese dhe nuk e ka udhëzuar paditësin të saktësoj padinë.



Fjalë për fjalë padia cek se gjykata do të gjykoj për të pandehurin të rikthej kushtet e mëparshme në parcelë. Kjo është vetëm kopja nga dispozitat e nenit 25, jo padia e duhur. Parashtruesit e ankesave të cilët i fillojnë veprimet për rikthimin e kushteve do të saktësojnë kushtet e sakta të cilat duan ti rikthehen. Në rastin nën çështje [REDACTED] duhet të saktësoj kushtet e mëparshme të cilat ajo do ti rikthehen dhe në veçanti cilat ndërrime do të hiqen.


Në këtë kuptim shkalla e parë duhet ta ftoj atë sipas nenit 102.1 LPK.

Prandaj, aktvendimi i ankimmuar do të hedhet poshtë dhe rasti do të rikthehet shkallës së parë për vazhdimin e procedurës së shkallës së parë me udhëzimet e përmendura më lartë.

Për shkak të arsyeve të cekura më lartë tupi gjykues i shkallës së dytë merr aktvendimin e tyre.

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN

A.c. Nr. 205/09 më 19.02.2010



Kryetar i trupit gjykues
Vladimir Kanev

E përkthyer nga gjuha angleze, S. Turtulla